Zgjatje e Përjashtimit të Përkohshëm në Zbatimin e SNRF 9

Ndryshime të SNRF 4

Janë ndryshuar paragrafët 20A, 20J dhe 20O. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Përjashtime të përkohshme nga SNRF 9

20A **SNRF 9 trajton kontabilitetin për instrumentet financiare dhe zbatohet për periudhat vjetore që fillojnë në 1 janar 2018 ose më pas. Megjithatë, për një sigurues që plotëson kriteret në paragrafin 20B, ky SNRF jep një përjashtim të përkohshëm që lejon, por nuk kërkon, që siguruesi të zbatojë SNK 39 *Instrumentet Financiarë: Njohja dhe Matja* dhe jo SNRF 9, për periudhat vjetore që fillojnë përpara datës 1 janar 2023~~2021~~. Një sigurues që do të aplikojë përjashtimin e përkohshëm nga SNRF 9 duhet të:**

(a) **...**

...

20J Nëse një njësi ekonomike si rezultat i rivlerësimit nuk kualifikohet për më tej për një përjashtim të përkohshëm nga SNRF 9 (shih paragrafin 20G(a)), atëherë njësia ekonomike lejohet të vazhdojë të aplikojë përjashtimin e përkohshëm nga SNRF 9 vetëm deri në fund të periudhës vjetore raportuese që fillon menjëherë pas këtij rivlerësimi. Por, njësia ekonomike duhet të zbatojë SNRF 9 për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2023~~2021~~ e në vijim. Për shembull, nëse një njësi ekonomike duke aplikuar paragrafin 20G(a) më 31 dhjetor 2018(fundi i periudhës së saj vjetore), përcakton se ajo nuk kualifikohet më për përjashtimin e përkohshëm nga SNRF 9, atëherë njësia ekonomike lejohet të vazhdojë të zbatojë përjashtimin e përkohshëm nga SNRF 9 vetëm deri më 31 dhjetor 2019.

...

Përjashtim i përkohshëm nga kërkesat e veçanta të SNK 28

20O Paragrafët 35–36 të SNK 28 *Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta* kërkojnë që njësia ekonomike të zbatojë politika kontabël uniforme kur përdor metodën e kapitalit neto. Megjithatë, për periudhat vjetore që fillojnë para datës 1 janar 2023~~2021~~, njësisë ekonomike i lejohet, por nuk i kërkohet, të mbajë të njëjtat politika përkatëse kontabël të zbatuara nga pjesëmarrjet ose sipërmarrjet e përbashkëta si më poshtë:

(a) ...

...

 © Fondacioni i SNRF-ve